




**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

**STREETLAW** INC



FONDACIONI KOSQIAR PER SHOQERI CIVILE  
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION



## AKADEMIA PËR UDHËHEQËSI NË KOMUNITET

### Thirrje për të rinjtë e moshave 18-24 vjeç

## MBI AKADEMINË

Bëhu pjesë e Akademisë tonë për Udhëheqësi në Komunitet për tu trajnuar dhe mbështetur nga KCSF për tu bërë aktivistë dhe aktiviste, të aftë për tu organizuar në mënyrë efektive dhe për të sjellë ndryshime pozitive në komunitetin tuaj.

Programi 14 javor i Akademisë do t'ju ndihmojë të zhvilloni aftësitë për organizim dhe zbatim të nismave në komunitet, të ndërtoni rrjet me aktivistë dhe profesionistë tjerë për tu bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në komunitetin dhe qytetin ku jetoni.

## SI TË APLIKONI?

Shumë e thjeshtë! Nëse jeni 18-24 vjeçarë ose vjeçare nga Prishtina, Podujeva, Drenasi, Obiliqi, Fushë Kosova apo Lipjani, klikoni në <https://www.surveymonkey.com/r/NVSQ6Z3> dhe plotësoni formën. Aplikimi do të jetë i hapur deri më 2 dhjetor 2022, në ora 23:59. 25 pjesëmarrës do të përzgjedhen për të filluar këtë rrugëtim të të mësuarit dhe aktivizimit në komunitet.

Nëse pranoheni dhe përkushtoheni që të përfundoni programin e Akademisë (15 dhjetor 2022 – 19 Mars 2023), do të merrni përkrahjen dhe përgatitjen më të mirë të mundur për të organizuar komunitetet tuaja dhe të sjellni ndryshime me përkrahje të Programit për Angazhim Qytetar dhe organizatave partnere. Pas përfundimit të Akademisë, gjithashtu do të pranoni certifikatë, dhe do të jeni në pozitë për të shërbyer si pikë referuese dhe përkrahëse për aktivizëm e pjesëmarrje në jetën publike për anëtarë tjerë të komunitetit ku jetoni.

## NËSE PËRSHTATENI NË PROFILIN SI MË POSHTË, EJANI ME NE!

- Jeni të moshës 18 – 24 vjeç;
- Jeni aktiv në komunitetin tuaj, në shkollë, organizata lokale, jeni angazhuar si vullnetar ose vullnetare dhe jeni të interesuar të rrisni njohuritë dhe aftësitë për tu organizuar dhe angazhuar për ndryshime pozitive, probleme dhe çështje tjera me të cilat ballafaqoheni në komunitetin tuaj;
- Nëse jeni aktiv në zonat rurale ose vini nga komunitetet joshumicë, edhe më mirë!
- Jeni të interesuar në pjesëmarrjen e të rinjve, organizimin e shoqërisë civile dhe aktivizmin në komunitet;
- Jeni të gatshëm dhe të motivuar për t'u bashkuar dhe për të përfunduar tërë ciklin e Akademisë, si edhe angazhimet e mundësitë tjera që pasojnë pas Akademisë.

## RRETH PROJEKTIT

Programi për Angazhim Qytetar është iniciativë pesë vjeçare që zbatohet nga KCSF në partneritet me misionin e USAID në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij partneriteti është të ushqejë kulturën e aktivizmit që e bën jetën në lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të kujdesshme dhe më kuptimplotë. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, programi do të realizojë një numër të veprimeve të bazuara në tre shtylla thelbësore: angazhimin e komunitetit, rritjen e besimit ndër-shoqëror si dhe zgjerimin e mobilizimit dhe burimeve të reja.

### Na kontaktoni:

Nëse ju duhen më shumë informata, na kontaktoni në e-mail [aplikimi@kcsfoundation.org](mailto:aplikimi@kcsfoundation.org), apo në rrjetet tona sociale në:



<https://www.facebook.com/KCSFoundation>



[https://www.instagram.com/kcsf\\_foundation/](https://www.instagram.com/kcsf_foundation/)



<https://www.linkedin.com/company/kosovar-civil-society-foundation-kcsf/>

## NË FUND TË AKADEMISË, JU DO TË JENI NË GJENDJE TË:

1. Përshkruani parimet themelore të demokracisë dhe rolin e qytetarëve dhe qytetareve në ruajtjen dhe zhvillimin e demokracisë;
2. Të kuptoni dhe përshkruani zhvillimin demokratik në Kosovë, përfshirë dobësitë, sfidat dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm;
3. Identifikoni problemet dhe çështjet kryesore që preokupojnë lagjen, qytetin tuaj, apo grupin e komunitetit të cilit i përkisni, dhe mundësitë për adresim të këtyre problemeve përmes angazhimit qytetar;
4. Përmirësoni aftësitë tuaja të udhëheqësisë dhe aktivizmit, duke përfshirë të menduarit kritik, komunikimin, zgjerimin e grupit të përkrahësve dhe komunitetit, si dhe aftësitë hulumtuese;
5. Përpiloni një nismë efektive për të adresuar një çështje në komunitetin tuaj;
6. Demonstroni besim të shtuar në aftësitë tuaja për të krijuar ndryshime pozitive shoqërore;
7. Bashkëpunoni dhe zgjeroni rrjetet tuaja personale dhe profesionale me të tjerët që angazhohen për ndryshime pozitive në Kosovë.